

SKEMA PËR VLERËSIM TË TESTIT NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA PAS PËRFUNDIMIT TË KLASËS IX, MAJ 2016

DETYRA 1.: Në stadiumin e Podgoricës. (*Vërejtje: Pranohet edhe nëse nxënësi shkruan Në Podgoricë ose Në Mal të Zi*)

1 pikë

DETYRA 2.: Që shikuesit më lehtë ta gjejnë vendin në vet në stadium./Që shikuesit të gjenden më lehtë. (*dhe përgjigje tjera të sakta*)

1 pikë

DETYRA 3.: është rrethuar numri 2. hyrjen VIP dhe PRESS

1 pikë

DETYRA 4.: Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon shkronjën **C** ku shkruan **hyrja, tribuna e jugut**



DETYRA 5.: Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon nën A (2. një ngjarje jo e vërtetë) dhe e shpjegon saktë përgjigjen (*P.sh. nuk ekziston peroni nëntë dhe tri të katërtat dhe nuk mund të kalohet përmes murit ndarës/përmes murit ose përgjigje tjera të sakta.*)

Vërejtje:

1. Nxënësi **nuk merr 1 pikë** nëse është përgjigjur saktë vetëm në pyetjen nën A, kurse në përgjigjen nën B nuk është përgjigjur saktë, gjegjësisht nuk e ka shpjeguar përgjigjen.

2. Nxënësi **merr 1 pikë** nëse nuk ka dhënë përgjigje nën A ose e ka rrethuar përgjigjen e gabuar (1. një ngjarje e vërtetë), por e ka shpjeguar saktë përgjigjen në detyrën B, sepse konsiderohet se i ka shpëtuar kjo.

DETYRA 6.: stacioni hekurudhor/peronat në stacionin hekurudhor *(dhe përgjigje tjera të sakta)*

1 pikë

DETYRA 7. : gjithsej **2 pikë**

A) rrethuar përgjigja 2. gruaja trashaluqe

1 pikë

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Ia ka sqaruar si ta gjej peronin nëntë dhe tri të katërtat/e ka mësuar si të kaloj përmes murit ndarës dhe të arrij deri te treni *(dhe përgjigje tjera të sakta)*

DETYRA 8.: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Ka arritur të vij deri te treni i cili nis në orën 11 për në Hogvorts/E ka mposhtur frikën dhe ka kaluar përmes murit ndarës ndërmjet peronit nëntë dhe dhjetë/ka arritur të vij deri te platforma nëntë dhe tri të katërtat/Ka arritur deri te treni për Hogvorts *(dhe përgjigje tjera të sakta)*

DETYRA 9.: është rrethuar numri 4. Lokomotiva me avull e purpurt e kuqe qëndronte pranë peronit e mbushur me njerëz.

1 pikë

DETYRA 10.: gjithsej **2 pikë**

A) krahasimi

1 pikë

B) hark prej guri, betoni ose hekuri që bëhet sipër dyerve, dritareve, ndonjë kalimi etj. *(dhe përgjigje tjera të sakta)*

1 pikë

DETYRA 11.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan se ka të drejtë bashkëbiseduesja 1 sepse në tekst përmenden shprehjet e skenave, aktori/dragoi i cili është bërë në mënyrë kompjuterike/aktori kumton si është ndier derisa e ka incizuar atë skenë *(dhe përgjigje tjera të sakta)*

DETYRA 12.: gjithsej **3 pikë**

A) 1 pikë - nëse nxënësi ka rrethuar numrin 4. kallëzore

B) 2 pikë - nëse nxënësi ka shkruar saktë përkatësinë e pjesës së ligjëratës për fjalët:

pastaj – ndajfolje

pranë – **parafjalë**

1 pikë – për çdo pjesë të ligjëratës që është shkruar saktë

DETYRA 13.: gjithsej **4 pikë**

A) 2 pikë - nëse nxënësi nga parashtesa dhe folja ka formuar saktë dy folje të reja, p.sh.:

nën+vleftësoj

për+vetësoj etj.

1 pikë – për një folje të re të formuar nga parashtesa dhe folja

B) 2 pikë – nëse nxënësi ka shkruar saktë me shkronja të dy numrat e dhënë:

17- shtatëmbëdhjetë

600 - gjashtëqind

1 pikë - nëse nxënësi ka shkruar saktë vetëm një numër me shkronja

DETYRA 14.: Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen plotësisht të saktë: **Kush?; Çfarë?/Çka?; Ku?; Kur?; Si/Përse?**

DETYRA 15.: gjithsej **3 pikë** (nxënësi merr nga **1 pikë** për çdo përgjigje të saktë – titulli i veprës nga e cila është shkëputur fragmenti i dhënë dhe emri dhe mbiemri i autorit të saj):

1. “Bagëti e Bujqësia” -Naim Frashëri (**1 pikë**)
2. “Plaku dhe deti” - Ernest Heminguej (**1 pikë**)
3. “Andrra e jetës” – Ndre Mjeda (**1 pikë**)

DETYRA 16.: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: **personifikimin/ apostrofin**

Vërejtje: Nxënësit i pranohet **1 pikë** nëse ka shkruar ose njërën ose tjetrën.

DETYRA 17.: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar:

1. Poezia nga e cila janë shkëputur këto vargje është patriotike **S**
2. Kjo poezi titullohet sipas babait të poetit **P**
3. Vargjet kanë rimë **S**
4. Vargjet kanë ritëm të shpejtuar **P**

DETYRA 18.: Nxënësi merr **1 pikë** nëse është përgjigjur: **mbiemër**

DETYRA 19.: gjithsej 2 pikë

A) *fshini, ndarë, bashkon, etj.*

1 pikë

B) *s' do të vetet*

1 pikë

DETYRA 20.

Skema për vlerësimin e hartimit *NJË DITË PARA PROVIMIT TË MATURËS SË VOGËL*

Përmbajtja – 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi:

merr 1 pikë për një përgjigje më të thjeshtë për rëndësinë e ditës kur e jep provimin e Maturës së Vogël ose të rëndësisë së saj një dite më parë.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse përshkruan shkurt ndjenjat e veta dhe disponimin e vet para dhënies së provimit.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 3.

Nxënësi:

merr 1 pikë në qoftë se shkruan shkurt nëse ka menduar ose nuk ka menduar për detyrat e mundshme, peshën e tyre, llojin.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse më thjeshtë përshkruan mënyrën e përgatitjes për provim.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 5.

Nxënësi:

merr 1 pikë për një përshkrim më të thjeshtë dhe një sqarim nëse ka pasur tremë apo jo një ditë para provimit.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
<p>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, përdorimi i figurave stilistike</p> <p>2 pikë</p>	<p><u>GRAMATIKA</u></p> <p>→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës; rumbullakimi kuptimor i fjalisë, renditja e saktë e fjalëve në fjali)</p> <p>2 pikë</p> <p><u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>2 pikë</p>	<p>→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij</p> <p>1 pikë</p>	<p>→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike</p> <p>1 pikë</p>

	<p>Gjithsej 4 pikë <u>GRAMATIKA</u></p> <p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja të fjalitë e ndërmjetme, inversioni, të fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë Gjithsej 2 pikë</p>		
--	---	--	--